



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS FRËNGE



PROGRAMI I LËNDËS:
GJUHË E HUAJ C (2) Frengjisht

Ngarkesa: kredite : 6ECTS; leksione - /seminare: 60

Viti akademik / semestri kur zhvillohet: Viti I, Semestri: II

Lloji i lëndës: Lëndë me detyrim

Programi i studimit: Master i Shkencave në “Përkthim teknik, letrar dhe Interpretim”

Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJET DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektiva të përgjithshme lëndore: Ky modul kërkon një angazhim të vazhdueshëm nga ana e studentit si dhe një pjesëmarrje aktive gjatë seancave pasi mbështetet në metodën interaktive të mësimdhënies për përvetësimin e kësaj gjuhe dhe arritjen e një komunikimi të lirshëm.

Metoda e zgjedhur është Alter Ego B2+ e cila do të plotësojë dhe do të thellojë më tej njohuritë e marra paraprakisht si ato gjuhësore, komunikuese edhe kulturore në gjuhën frënge. Studentit do të përvetësojë dhe përmirësojë kompetencat gjuhësore dhe leksikore, kompetencat e të kuptuarit dhe të shprehurit me shkrim dhe me gojë nëpërmjet studimit të teksteve me natyrë informuese, përshkruese, shpjeguese, argumentuese. Të kuptuarit me shkrim dhe me gojë, të shprehurit me shkrim dhe me gojë, do të ofrohen nëpërmjet materialeve të ndryshme me natyrë autentike të përshtatur didaktikisht për qëllim të të mësuarit. Do të favorizohet reflektimi i studentit në praktikën gjuhësore me shkrim dhe me gojë. Qasja pedagogjike bazohet në vëzhgimin, në analizën dhe në ndërveprimin. Në këtë mënyrë, studenti do të njihet edhe me elementët kulturor dhe të qytetërimit të gjuhës frënge.

Objektiva specifike lëndore: Arritja e nivelit B2 në komunikim sipas parametrave të përcaktuara nga Kuadri Europian i Përbashkët për gjuhët; Aftësia për të komunikuar me gojë dhe me shkrim në mënyrë të pavarur mbi tema të ndryshme të jetës së përditshme personale dhe profesionale; Aftësia për të përzgjedhur dhe përdorur fjalorin përkatës mbi temat si shkolla, profesioni, argetimeve etj; Aftësia për të treguar një ngjarje në kohën e shkruar dhe për të shprehur emocione, dëshira apo ndjenja të ndryshme nëpërmjet letrave personale; Aftësia për të shprehur gojarisht dhe me shkrim në mënyrë të thjeshtë mbi tema që kanë të bëjnë me përvojën e ngjarjeve, endrrat e shpresat apo qëllimet tona apo të shprehim dhe reagojmë me opinionet tona mbi një ngjarje. Të thellojë dhe të përmirësojë njohuri thelbësore të strukturave gjuhësore të gjuhës frënge në planin leksikor, sintaksor dhe gramatikor duke respektuar dhe saktësuar specifikat fonetike; Të zhvillojë aftësitë e vëzhgimit dhe analizës, si dhe shumë strategji të të nxënies që do të çojnë progresivisht drejt autonomisë gjuhësore;

Rezultate të pritshme:

- Aftësi komunikimi me gojë e me shkrim, aftësi për të kuptuar dhe lexuar tekste të ndryshme sipas parametrave të përcaktuara për nivelin B2;
- Kompetenca shoqërore dhe qytetare: nxitja e punës në grup dhe sensibilizimi për tema të ndryshme sociale e kulturore;
- Kompetenca ndërkulturore: njohja e kulturave të ndryshme dhe e diversitetit kulturor.
- Të kuptojnë pikat kryesore të një diskutimi kur përdoret një gjuhë e qartë dhe standarde dhe nëse bëhet fjalë për gjëra të njohura në punë, shkollë, kohë të lirë etj.;
- Të jetë në gjendje të prodhojë një ligjërim të thjeshtë dhe koherent për tema të njohura dhe në fushat e tij të interesit